



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore**  
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

---

Prishtinë 07.10.2016

**Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore shpall në mbrojtje të përhershme asetet e trashëgimisë kulturore**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në mbledhjen e mbajtur dje më 06 Tetor 2016, bazuar në kompetencat e tij ligjore ka bërë shpalljen e njëzetetë (23) aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme të cilat janë propozuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Procesi i shqyrtimit të aseteve të propozuara është zhvilluar në disa faza, duke përfshirë analizën e dosjeve të propozuara, kualifikimin dhe vlerësimin e gjendjes së tyre. Ky proces është finalizuar me shpalljen e 23 aseteve në mbrojtje të përhershme pas shqyrtimit, vlerësimit dhe kualifikimit të propozimeve nga MKRS. Këto asete të shpallura bëjnë pjesë në dy kategori, trashëgiminë arkeologjike dhe arkitekturale.

Procesi i shpalljes në mbrojtje të përhershme zhvillohet për herë të parë në Republikën e Kosovës dhe me të drejtë konsiderohet zhvillim historik për trashëgiminë e vendit tonë duke e afruar në këtë mënyrë edhe më shumë anëtarësimin e Kosovës në UNESCO si dhe mekanizmat e nismat e tjera ndërkombëtare. Njëkohësisht ofron mbrojtje ligjore të nevojshme për ruajtjen e trashëgimisë kulturore duke u bazuar dhe mbështetur në kriteret profesionale të përcaktuara në legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar.

Me respekt,

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore